

# PrishtinaSot

[Ballina](#) [Lajme](#) [Sport](#) [Kryeqyteti](#) [Shëndetësi](#) [Art](#) [Teknologji](#) [INFORMACIONE](#) [Kuriozitete](#) [Showbiz](#) [Video](#)[Ballina](#) / [Shëndetësi](#)

## Shpëtimi i jetëve nga kardiokirurgët - mision i vëllezërve Kojqiqi

25.03.2018 | 16:41

Fatos, Besnik dhe Arben Kojqiqi, janë tre vëllezërit specialistë të sëmundjeve të zemrës. Që të tre janë mjekë nga fusha e kardiologjisë. Fatosi është specialist në Kardiokirurgji sikurse edhe Besniku, ndërsa Arbeni specialist Karditorakal.

Që të tre punojnë në Spitalin Amerikan në Prishtinë dhe Tiranë, ku kanë arritur të shmangin vdekjen e shumë pacientëve gjatë këtij viti.

Dr. Fatosi ka bërë një prezantim të punës së repartit të Kardiokirurgjisë në Prishtinë, ku tregon se viti 2017 ka qenë mjaft i suksesshëm, duke i krahasuar rezultatet me qendrat e ndryshme në Evropë dhe botë.

Sipas tij, pas publikimit të rezultateve janë vet pacientët që mund të zgjedhin kryerjen e një operacioni të suksesshëm.

## Shëndetësi



Shefi i Shëndetësisë pritet të intervistohet pse QKUK-ja furnizohet me infuzione të kompanisë serbe

31.05.2019

| 11:27

[Më shumë](#)

Si të largoni dhimbjet e migrenës?

13.05.2019

| 15:05

[Më shumë](#)

Si të ulni tensionin e gjakut për vetëm pesë minuta dhe pa ilaçë

07.03.2019

| 15:30

[Më shumë](#)

A mund të shërohet kanceri vetëm me lëng të karrotave?

07.03.2019

| 14:59

[Më shumë](#)

## INFORMACIONE

Ai thotë se janë të rralla spitalet që i bëjnë publike raportet vjetore, për shkak të vdekshmërisë së patientëve, transmeton GSH.

“Duke pasur një përvojë pune shumë vjeçare në Gjermani dhe Austri, ndjej obligim për informim sa më korrekt të publikut. Publikimi i rezultateve në mjekësi është i ndjeshëm, për të gjitha qendrat, por duhet të jetë i drejt”, thotë kardiokirurgu.

Ai shpjegon se intervenimet janë me rrezikshmëri për shkak se varen nga sëmundjet e patientëve, koha e intervenimit, funksioni i zemrës, mosha, gjinia e organet tjera. Mirépo ai insiston se është kirurgu që duhet të marr përgjegjësinë për trajtimin e këtyre rasteve.

“Marrja e përgjegjësisë nga kirurgu, trajtimi i këtyre rasteve të vështira operative, është faktori kryesor që përcakton së fundi edhe rezultatet përfundimtare. Prandaj publikimi i rezultateve sa më në detaje jep një pasqyre me komplete dhe tregon seriozitetin e stafit mjekësor dhe poashtu edhe të Spitalit”, deklaron Dr. Fatosi. “Spitalet më të njoftura universitare në gjermani, kanë publikuar një vdekshmëri për vitin 2016, që në rastet më të mira (pa urgjencia dhe pa disekcione) paraqitet me 1,5 % deri ne 2,5 % dhe duke u lavdruar me këto rezultate që janë nën mesataren e rrezikshmërisë me 3%”, shton ai tutje.

Nga përvuja e tij në Gjermani, tregon se përveç ekipit mjaft të mirë të anestezionit, reanimatorëve, stafit infermieror dhe kirurgëve, ata kanë edhe gjithë potencialin teknik si programimin e zemrave artificiale: LVAD,RVAD,BVAD pastaj ECMO ose ECLS.

Poashtu edhe faktorët e koagulimit të gjakut, bëjnë që këto qendra universitare të paraqesin një vdekshmëri totale që në të gjitha rastet kalon mbi 1 për qind.

“Duhet theksuar që e gjithë kjo teknologji si programi i zemrës artificiale me LVAD,RVAD,BVAD dhe faktorët e koagulimit që janë shumë të shtrenjtë nuk gjinden ne Ballkanin perëndimor e leje me në atë lindor. Në Ballkanin perëndimor (Kosovë dhe Shqipëri) kemi ende problemet elementare të mungesës së gjakut dhe Trombociteve. Një mungesë e këtyre Produkteve esenciale, shkakton edhe rritjen e vdekshmërisë, thjeshtë si pasojë e gjakderdhjes”, thotë kardiokirurgu Kojqiqi.

Ai shton se patientët mund të marrin çdo shërbim në zemër brenda Kosovës, përveç transplantit që nuk i lejuar me ligj.

“Sido që të jenë numrat, jo gjithherë mund të shpëtonim secilën jetë. Kjo vdekshmëri edhe pse e ulët në Kardiokirurgji, për ata që nuk shpëtuan është tepër e madhe. Shprehim keqardhjen tonë të thellë për çdo pacient, që përkundër shërbimit maksimal nga e gjithë ekipi i kardiokirugjisë , fatkeqësish nuk ia dolën me sukses të vazhdojnë jetën e tyre pranë familjareve”, është shprehur Dr. Kojqiqi.

Ai iu ka bërë thirrje kolegëve të tij që t'i bëjnë publike rezultatet e punës ku do të informoheshin drejt patientët. “Mos të harrojmë, secili nga ne mund të bëhet Pacient dhe jo secilit, do t'i premtoj koha të kërkoj pa nevojë një spital jashtë vendit”, ka thënë kardiokirurgu. /GSH



Për të lehtesar gjetjen, kemi kënaqësinë të Ju sjellim LISTËN e AMBASADAVE të cilët për nevojat Tuaj mund t'i

Më Të Fundit

Më Të Lexuara

I dashur bashkëshort, kurrë nuk e kisha imaginuar që vajza jonë të ngjante ty kaq shumë

19.02.2019 | 16:16

Dashuria ime,Kur kemi énderruar të ndértojmë një familje bashkë, unë kam menduar se fëmija që do të

Deputetët e LDK'së dembelët më të mëdhenj:

Munguan 220 herë

22.08.2018 | 00:00

Kuvendi i Kosovës gjatë sesionit pranveror të këtij viti ka mbajtur gjithsej 27 seanca, prej të cilave 20 kanë

Si e mashtroi kompania e cila përdori Bes Kallakun si imazh suksesi

20.04.2018 | 17:41

Nuk ka asnjë gjurmë të drejtuesve të kompanisë “Gulf”, e cila papritur ka mbyllur aktivitetin në të gjitha pikat e

AVOKATËT

13.04.2018 | 08:34

Për tu lehtesar gjetjen, kemi kënaqësinë të ju sjellim LISTËN E AVOKATËVE të cilët për nevojat Tuaj mund t'i

Dy dashuritë e mëdha

29.03.2018 | 23:15

Paulo CoelhoThonë se gjatë jetës sonë kemi dy dashuri të mëdha. Një me të cilin/cilën do të martohesh ose do

## Kryeqyteti


Te gjitha >

## Art



### 20 aktivitete për 20 vjetorin e çlirimtë të Prishtinës

Aktivitet për çdo grupmoshë nga Komuna e Prishtinës në hashkënumim me organizata





Më shumë



## Shembet dheu në Prishtinë: Policia evakuon banorët, ndërpritet edhe mësimi

Në rrugën 'Qamile Jaka' në lagjen e Muhamxherëve në Prishtinë, mbërëmë ka filluar shembja e ...

[Më shumë](#)



## Një milion lule do të mbjellen në Kryegytet

7 Marsi, Dita e Mësuesit dhe 8 Marsi, Dita Ndërkombëtare e Grusas këtë vit shënohet me ...

[Më shumë](#)



## Prindërit: Nuk paguajmë faturat e çerdheve për kohën e grevës

Mëngjesin e sotëm u raportua se si Komuna e Prishtinës ka kërkuar nga prindërit të ...

[Më shumë](#)



## Thëniet më të bukura për Politikën



"Gënjeshtra të zë rob,  
e vërteta të çliron."

## Thënie të Vërteta për Gënjeshtrat



I dashur bashkëshort,  
kurrë nuk e kisha  
imaginuar që vajza jonë  
të ngjante ty kaq shumë

[Ballina](#) | [Lajme](#) | [Sport](#) | [Kryeqyteti](#) | [Shëndetësi](#) | [Art](#) | [Teknologji](#) | [INFORMACIONE](#) | [Kuriozitate](#) | [Showbiz](#) | [Video](#)

Portali 'PrishtinaSot' është media "online" e pavarur, e themeluar nga një grup gazetarësh kosovarë dhe është pjesë e Kompanisë 'Media Pro'. Materialet dhe informacionet mund të kopjohen, të shtyhen dhe të përdoren por vetëm pas referimit të qartë të burimit të Portalit Prishtina Sot, në përputhje me kushtet e përdorimit.

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara © 2015 Prishtinasot.info

AS

